

UNIVERSITETI I MITROVICËS “ISA BOLETINI”

FAKULTETI I EDUKIMIT



PUNIM DIPLOME

Gëzime Hajdari

Mitrovicë, 2019

UNIVERSITETI I MITROVICËS “ISA BOLETINI”

FAKULTETI I EDUKIMIT



PUNIM DIPLOME

**LOJA SI MJET EDUKATIV QË NXITË TË
MËSUARIT NË EDUKIMIN PARASHKOLLOR**

Mentori/ja:

Prof. Ass. Dr. Edita Bekteshi

Kandidatja:

Gëzime Hajdari

Mitrovicë, 2019

UNIVERSITY OF MITROVICA “ISA BOLETINI”

FACULTY OF EDUCATION



DIPLOMA THESIS

THE PLAY AS AN EDUCATIONAL TOOL THAT ENCOURAGES LEARNING IN PRESCHOOL EDUCATION

Mentor:

Prof. Ass. Dr. Edita Bekteshi

Candidate:

Gëzime Hajdari

Mitrovicë, 2019

UNIVERSITETI I MITROVICËS “ISA BOLETINI”

FAKULTETI I EDUKIMIT

PROGRAMI PARASHKOLLOR



PUNIM DIPLOME

Lënda: Gjuhë angleze

Titulli i punimit: Loja si mjet edukativ që nxitë të mësuarit në edukimin parashkollor

Emri dhe mbiemri: Gëzime Hajdari

Statusi i studentit: I rregullt

Numri i amzës(ID Regjistri): 1506021008

Niveli i studimeve: Bachelor

Programi i studimit: Parashkollor

Mentori/ja i/e punimit: Prof. Ass. Dr. _____

Aprovuar prej komisionit:

1. /Emri Mbiemri, Titulli/ _____, mentor
2. /Emri Mbiemri, Titulli/ _____, anëtar
3. /Emri Mbiemri, Titulli/ _____, anëtar

Data e aprovimit: _____

DEKLARATA E AUTORËSISË

Nën përgjegjësinë time, deklaroj se ky punim është punë origjinale e imja. Ky studim nuk është paraqitur asnjëherë para ndonjë komisioni tjetër dhe nuk përmbanë materiale të shkruara nga dikush tjetër përveç rasteve të civateve të referuara dhe burimeve të cilat janë në listën e referencave.

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi

Data, Vendi

DEDIKIM

Me kënaqësinë më të madhe, këtë punim i'a dedikoj familjes time e në veçanti prindërve të mi prej të cilëve kam pasur mbështetjen më të madhe përgjatë këtij rrugëtimi.

FALËNDERIM

Ishte një rrugëtim i gjatë i cili ndonjëherë është përcjellur me vështirësi por ç'është më e rëndësishmja ka pasur shumë vlerë të madhe. Prandaj, nëse ne duam që të kemi sukses gjatë një rrugëtimi të caktuar atëherë ne duhet të përkushtohemi plotësisht e të punojmë me shumë mund. Në disa raste, kjo bëhet shumë më e lehtë duke pasur gjithmonë në krahë njerëzit e afërm e më të rëndësishëm.

Në fillim, falënderoj mentoren time Profesoreshën Dr. Edita Bekteshi për përkrahjen e vazhdueshme që nga fillimi e deri në përfundimin e këtij punimi. Poashtu, falënderoj edhe Profesorët e Universitetit të Mitrovicës "Isa Boletini", përkatësisht Profesorët e Fakultetit të Edukimit për mundin që kanë dhënë përgjatë këtyre viteve studimi që unë të jem e përgaditur në mënyrë profesionale. Falënderoj edhe koleget për ndihmën që më kanë ofruar në kohën kur është kërkuar nga ana e tyre.

Në veçanti falënderoj familjen time për përkrahjen e palodhshme që më kanë japë gjithë këto vite studimi, gjë që ka qenë motivi kryesor për të arritur deri në fund.

Faleminderit të gjithëve!

PËRMBAJTJA

DEKLARATA E AUTORËSISË.....	I
DEDIKIM.....	II
FALËNDERIM.....	III
ABSTRAKTL.....	VII
ABSTRACT.....	VIII
1. HYRJE.....	1
1.1 Edukimi parashkollor (Preschool education).....	3
1.1.1 Rëndësia e edukimit parashkollor (The importance of preschool education)...	3
1.1.2 Historiku i edukimit parashkollor (History of preschool education).....	5
1.1.3 Metodologjitë në edukimin parashkollor (Methodologies in preschool education).....	6
2. METODOLOGJIA.....	9
3. DISKUTIMI.....	10
3.1 Loja (The play).....	10
3.1.1 Loja në edukim të hershëm (The play in early development).....	11
3.1.2 Benefitet e lojës (Benefits of play).....	11
3.1.3 Historiku i lojës (History of play).....	13
3.1.4 Teoritë mbi lojën (Theories of play).....	13
3.1.5 Përmbajtja e lojës (Content of the game).....	15
3.2 Gjashtë fazat e lojës (sipas Parten dhe Neëhall).....	16
3.2.1 Qëllimet e lojës (Goals of the game).....	17
3.2.2 Loja në mendimin pedagogjik (The play in pedagogical thought)	18
3.2.3 Loja dhe edukimi (The play in the education).....	19
3.2.4 Loja dhe të mësuarit gjatë gjithë jetës (The play and lifelong learning).....	20
3.2.5 Kënaqësia është çelësi i lojës (Joy is the heart of play).....	20

3.3 Të mësurait në zhvillimin e aftësive (Learning to learn skills)	21
3.3.1 Ndërlidhja e fushave zhvillimore jetësore të fëmijëve (Child development is interconnected).....	21
3.3.2 Përdorimi i lojës për të ndihmuar fëmijët në vështirësi emocionale (The usage of play to help children to overcome emotions).....	22
3.3.3 Lojërat përmes të cilave mund të mësohet një gjuhë e huaj (Learning foreign languages based on plays).....	23
4. KONKLUKIME DHE REKOMANDIME.....	25
5. REFERENCAT.....	27.

LISTA E FIGURAVE

Figura 1. Loja me bashkëmoshatarë.....	10
Figura 2. Loja Kloo.....	23
Figura 3. Loja Shënjimi (Spot it).....	24

ABSTRAKTI

Loja është aktiviteti kryesor në periudhën parashkollore në bazë të së cilës edukohet dhe përgaditet për jetë fëmijë, prandaj synimi i këtij punimi është që të japë sa më shumë informacione në bazë të literaturës së shtjelluar dhe studimeve të ndryshme të cilat janë bërë nga autorë të shumtë rreth lojës dhe rëndësisë së saj.

Poashtu, në këtë punim flitet edhe për periudhën parashkollore, periudhë kjo e cila ka rëndësi të madhe në edukimin e fëmijëve dhe procedurave të lojërave të cilat organizohen me qëllim të mësimin të gjuhëve të huaja. Periudha e edukimit parashkollor dhe loja si mjet edukativ kryesor përgjatë kësaj kohe kanë rëndësi të madhe në zhvillimin e fëmijës në aspektin tërësor. Periudha parashkollore konsiderohet periudha më e rëndësishme përgjatë të cilës vihen themelet për jetën, fëmijët krijojnë personalitetin e tyre e poashtu përfitojnë në fusha të ndryshme të rëndësishme për jetën. Loja paraqet formën përmes së cilës fëmijët zhvillohen si në aspektin social, emocional, intelektual por edhe në atë fizik, pra zhvillohen në fusha të ndryshme të cilat ndërliken mes vete e në këtë mënyrë zhvillimi i fëmijëve është edhe më efikas.

E gjithë literatura dhe studimet shkencore tregojnë se loja është mjet edukativ mjaftë i rëndësishëm në fëmijërinë e hershme dhe se benefitet e saj janë të shumta në zhvillimin optimal të fëmijës.

Fjalët kyçe: Edukimi parashkollor, institucionet e edukimit parashkollor, loja, metodologjia, edukatore, ambienti, aktivitetet e të mësuarit, fëmijët, prindërit.

ABSTRACT

Play is the primary activity in the preschool period in which the child is educated and prepared for life, so the purpose of this paper is to provide as much information as possible on the basis of the extensive literature and various studies done by many authors about the play and its importance.

This paper also discusses the pre-school period, which is of great importance for the education of children and the play procedures organized for the purpose of learning foreign languages. The pre-school period and play as the main educational tool during this time are of great importance for the development of the child as a whole. The pre-school period is considered the most important period during which the foundations for life are laid, children create their own personality and also benefit in various important areas of life. The play is a form in which children develop both socially, emotionally, intellectually, but also physically, so they develop in different areas that are interconnected and thus the development of children is even more efficient.

All the literature and scientific studies show that play is an important educational tool in early childhood and that its benefits are numerous in the optimal development of the child.

Key words: preschool education, preschool institutions, play, methodology, educator, environments, learning activities, children, parents.

1. HYRJE

“Të mësuarit përmes lojës është vazhdimësi që sjellë bashkimin e sferave të jetës së fëmijëve si: shtëpinë, shkollën dhe botën më gjerë përgjatë kohës”

*Susan MacKay
Director of Teaching and Learning at
Portland children’s Museum*

Edukimi parashkollor përfshin edukimin e fëmijëve nga mosha 0-6 vjeç. Ky përfshin periudhën kryesore e cila ndihmon në zhvillimin e fëmijëve si në aspektin social, emocional, intelektual apo moral. Pra, përfshin periudhën kur fëmijët fillojnë të krijojnë personalitetin e tyre, e gjithçka që mësohet gjatë kësaj kohe arrihet nëpërmes lojës.

Loja është një ndër format më të rëndësishme dhe më të zakonshme që ndikon në ndërveprimin ndërmjet fëmijëve gjatë procesit të edukimit në nivelin parashkollor. Loja paraqet një kontekst të rëndësishëm për zhvillimin social të fëmijëve. Si aktivitet edukativ, ndihmon në përmirësimin e normave sociale dhe morale të cilat fëmijët i vëzhgojnë si në familje, shkollë por edhe në komunitet.

Ky aktivitet edukativ është një nga mënyrat përmes së cilës fëmijët e mësojnë pavarësinë dhe kapacitetet e bashkëpunimit. Gjatë procesit të edukimit parashkollor, fëmijët përmes lojës e përdorin gjuhën më mirë, krijojnë nivele më të larta të bashkëpunimit dhe nëpërmes kësaj ata arrijnë të lënë anash nevojat e tyre për hir të shokëve/shoqeve të grupit dhe kështu ata zhvillojnë aftësi pozitive të socializimit. Poashtu, ata fillojnë të mendojnë nga perspektivat e tjetrit dhe provojnë të krijojnë forma të ndryshme për zgjidhje të konflikteve.

“Është fakt i pranuar se gjashtë vitet e para të jetës së fëmijës janë vitet më kritike për shkak të ritmit të shpejtë të zhvillimit në këtë fazë. Këto janë vitet në të cilat truri i fëmijës zhvillohet me ritmin e shpejtë, formohen aftësitë personale dhe shoqërore dhe vendoset themeli për jetën. Kjo është një grupmoshë e cila kërkon edukim të kujdesshëm në një mjedis të pasur në mënyrë që t’i ndihmojë ata të zhvillojnë potencialin e tyre dhe të përparojnë” (B.K Tripathi, 2015:5).

Loja është një formë e cila përmbanë rregullat e veta dhe të cilat duhet të respektohen. Sipas burimit (Houghton et al., 2013) tregon se lojërat e ndihmojnë procesin e të mësuarit. Loja përdoret si mjet për të mësuar aftësi të ndryshme si bashkëpunimin, mendimin kritik, të qenit krijues, punën në grupe dhe zgjedhjen e problemeve. Si mjet edukativ, loja luan rol të madh në krijimin e vetëbesimit të fëmijëve. Ajo i gjallëron metodat e mësimdhënies të cilat në disa raste konsiderohen të mërzitshme (Boyle, 2011).

Loja konsiderohet njëri nga përbërësit më të rëndësishëm në jetën e fëmijëve. Përgjatë lojës fëmijët mund të mësojnë aftësi të ndryshme. Mjetet përbërëse të lojës siç janë, terreni dhe shoqëria kanë rëndësi në lojë, veçanërisht materialet e lojës kanë një ndikim pozitiv tek fëmijët për të mësuar dhe hulumtuar botën në mënyrë sa më të këndshme (Celebi Oncu & Ozbay, 2005). Loja është një aktivitet natyror i fëmijëve e cila ndihmon për të kuptuar zhvillimin dhe pikëpamjet e fëmijëve. Kur fëmijët bëhen të pjekur ata janë në gjendje që të përfaqësojnë nevojat e tyre mendërisht dhe përdorin procesin e të menduarit për të krijuar motive për lojë (Vig, 2007). Fëmijët duhet të kenë mundësi për të eksploruar me materiale dhe objekte të ndryshme sepse kjo mundësi zhvillon kreativitetin e fëmijëve (Saracho, 2002).

Duke u bazuar në autorë të huaj mbi edukimin parashkollor dhe lojën, qëllimi i këtij punimi është që të tregojë rreth edukimit parashkollor në përgjithësi, rëndësinë e kësaj periudhe në edukimin e fëmijës, e në veçanti të tregojë rreth lojës e cila është mjete kryesor edukativ në periudhën parashkollore si dhe emërtimet e procedurat e disa lojërave përmes së cilave mundemi t'iu mësojmë fëmijëve një gjuhë të huaj, në rastin tonë gjuhën angleze. Gjithë kjo duke përdorur literaturën në gjuhën angleze si gjuhë globale.

1.1 Edukimi parashkollor (Preschool education)

Edukimi parashkollor (preschool education), është periudhë e edukimit të fëmijëve e cila fillon që nga lindja e fëmijës dhe vazhdon deri në moshën 6 vjeçare. Ky është një proces i cili ofron larmi të ndryshme të shërbimeve në hapësirat e referuara për edukim të fëmijëve. Edukimi parashkollor është proces i cili përmban programe të ndryshme edukative (various educational programs) të cilat konsistojnë në zhvillimin e aspektit shëndetësor, fizik, mendor apo social të fëmijëve.

Themeli i procesit të edukimit të fëmijëve është përkrahja e idesë që fëmija të jetë në ‘qendër’ (center) gjatë këtij procesi të rëndësishëm jetësor. Pra, këtu hyjnë respektimi i nevojave apo dëshirave të fëmijëve (respect for needs or desires of childrens), mos të ketë dallime pa marrë parasysh ngjyrën, racën, etninë apo kushtet ekonomike të fëmijës ose edhe dallimin mes aftësive të tyre të zhvillimit (development skills). Kjo ide i mundëson fëmijëve që ta kenë më të lehtë të shprehin apo të tregojnë atë qka ata ndjejnë apo mendojnë. Periudha kohore përgjatë edukimit të fëmijëve mundëson bashkimin e forcave të faktorëve kryesorë në procesin edukativ të fëmijëve që janë prindërit dhe edukatorët (parents and educators).

Metodologjia me në qendër ‘‘fëmijën’’ ka këto karakteristika kryesore:

- Secili fëmijë ka forma të ndryshme të të nxënimit
- Secili fëmijë ka interesa dhe nevoja personale
- Secili fëmijë ka shprehi të ndryshme
- Kjo metodë ka një vend shumë të rëndësishëm në periudhën parashkollore
- Gjatë këtij procesi edukatorja dhe fëmijët duhet të bashkëpunojnë në mënyrë që të arrijnë një qëllim të caktuar (Ligjëratë e autorizuar).

1.1.1 Historiku i edukimit parashkollor (History of preschool education)

Sipas projektit Pre-K Now (Pew Charitable Trusts) që është i projektuar për edukimin parashkollor, nocioni i edukimit parashkollor ka filluar në fillim të viteve 1800 nga një nënë në Evropë e cila i ka mësuar fëmijët jashtë shtëpive të tyre. Në fillim, në Amerikë shkollat për edukim të fëmijëve nuk kanë qenë institucione të mirëfillta, mirëpo kanë qenë fabrikat e

ndryshme (factories), kishat (churches) dhe shtëpitë private (private house). Kështu që në vitin 1848 shteti i Wisconsin-it ka kërkuar që të bëhen ndryshime në kushtetutë në mënyrë që edukimi i fëmijëve të bëhet falas. Kështu pra, në vitin 1873 ka filluar programi i parë parashkollor për edukim të fëmijëve. Edhe shtetet e tjera të Wisconsin-it vazhduan me përkrahjen e udhëheqjes së tij mbi fushën e edukimit parashkollor të fëmijëve, krijimit të qendrave për kujdes të fëmijëve dhe se programi për edukim të tyre të bëhet në të gjitha vendet. Në vitin 1926 krijohet Shoqata Kombëtare për Edukimin e Fëmijëve të Rinj (National Association for the Education of Young Children) e cila kishte të bënte me përmirësimin e gjendjes së fëmijëve, cilësinë e institucioneve që kanë të bëjnë me arsimimin dhe zhvillimin e fëmijëve.

Në bazë të Departamentit të Shëndetit dhe Shërbimeve Njerëzore (Department of Health and Human Services) në SHBA, në vitin 1995, krijohet “Head Start”, program ky i cili ofronte shërbime për fëmijët të cilët kishin të ardhura të pakta, ndërsa tani ky konsiderohet program mjaftë i rëndësishëm i cili ofron shërbime për të gjithë fëmijët të cilët kanë prejardhje apo aftësi të ndryshme të të nxëniet (different learning abilities).

Sipas studimit ‘‘Alternativat e Metodologjive të Edukimit parashkollor dhe Aplikimi i tyre në Kosovë’’ (Shala, 2017) thuhet se në botë fillet e para të edukimit parashkollor gjenden që nga kohërat e lashta, përkatësisht në Greqinë antike. Njeriu i parë i cili kishte përshkruar shkallët e zhvillimit të fëmijëve kishte qenë Platoni, ku sipas tij loja (the game) dhe lodrat (toys) ishin mjetet kryesore të cilat ndikojnë fuqishëm në rritjen (growth) dhe zhvillimin (development) e tyre. Ndërsa Aristoteli ishte i pari i cili përshkroi format me të cilat punohet më fëmijët në periudhën parashkollore. Humanizmi dhe Renesanca janë kohërat përgjatë të cilave nuk ka pasur ndonjë zhvillim të edukimit parashkollor përveç formës se si është bërë edukimi i fëmijëve parashkollor.

Psikologë të ndryshëm kanë treguar rëndësinë e mënyrës se si trajtohet fëmiju dhe se zhvillimi i tyre duhet të bëhet përmes lojës dhe aktiviteteve të ndryshme si me muzikë (music) apo diçka tjetër.

Fridrih Frobel ishte themeluesi i parë i institucionit për edukim parashkollor, të cilin e emëroi si ‘‘Kindergarten’’, institucion ky i cili i ka ndihmuar botës për ngritje të nivelit të edukimit

si dhe mënyrave apo metodave (methods) të punës edukative. Ai e ka konsideruar fëmijërinë e hershme si një periudhë mjaftë të rëndësishme e cila ndihmon në njohjen e botës së jashtme e cila e rrethon fëmijën. Shekulli XX, mendohet të jetë periudha gjatë të cilës fusha e psikologjisë zhvillohet mjaftë shumë dhe pedagogë të ndryshëm merren me krijimin e teorive (theories) të ndryshme mbi zhvillimin e fëmijëve të cilat kanë ndihmuar në krijimin e programeve për edukim (education) të fëmijëve në fëmijërinë e hershme.

1.1.2 Metodologjitë në edukimin parashkollor (Methodologies in preschool education)

Në studimin “Alternativat e metodologjive të edukimit parashkollor dhe aplikimi i tyre në Kosovë” (Shala, 2017) theksohet se ekzistojnë disa metodologji në procesin e edukimit:

- a) *Metoda hap pas hapi (step by step method)* – i kushton rëndësi shumë të madhe bashkëpunimit të familjes, komunitetit si dhe mjedisit i cili i ndihmon fëmijës të ndjehet i pavarur (i lirë). Edukatorja luan një rol të rëndësishëm për shkak se në bazë të observimit (observation) ajo edhe i planifikon aktivitetet të cilat do t’i realizojë me fëmijët. Të gjitha veprimtaritë me fëmijët organizohen në disa qendra të cilat i ndihmojnë fëmijët që të angazhohen, të mësojnë dhe të jenë të interesuar (interested) gjatë gjithë kohës. Veprimtaria kryesore është loja, ku përmes saj institucioni mundohet që raporti me familjen dhe komunitetin të jetë në harmoni në të dyja mjediset. Fëmija është në “qendër” - centered. Mjetet që përdoren në këtë program preferohen të jenë mjete recikluese, jo shumë të kushtueshme, por që e bëjnë fëmijën të jetë kreativ dhe i angazhuar vazhdimisht.
- b) *Metoda Montessoriane (Montessori method)* – i kushton rëndësi mjedisit në të cilin vepron fëmija. Veçoritë mbi të cilat bazohet metoda e Montessorit janë: *respekti për fëmijën*, gjë që konsiderohet primare në punën me fëmijë, *fëmijëria moshë e mendjes thithëse*, *periudhat e ndjeshme në fëmijëri*, *pergaditja e mjedisit* e cila ka të bëjë me përshtatshmërinë dhe me mjetet të cilat ndikojnë në zhvillimin e fëmijës si dhe *vetëdukimin*, parim ky përmes të cilit Montessori e përkrahu idenë që fëmija të veprojë lirshëm me ambientin rrethues. Rëndësi tejet të madhe i kushtohet edhe pavarësisë së fëmijës, bashkëpunimit (cooperation) me bashkëmoshatarët si dhe edukatoren e cila ka

rol vëzhgues. Sipas Montessorit fëmijët mësojnë përmes shqisave si dhe materialeve nga druri të cilat janë të punuara nga vetë Montessori të cilat janë tërheqëse (attractive) për fëmijët.

- c) *Metoda majeutike (majeutic method)* – nocioni Majeutikë njihet që nga koha e Sokratit i cili duke bërë pyetje të shumta ai ndikonte në rritjen e interesimit të fëmijëve, gjë që ndikonte në zhvillimin e aftësive përmes të cilave fëmijët e kanë më të lehtë të arrijnë drejtë një qëllimi (goal) të caktuar. Themelues i kësaj metodologjie (methodologie) është Daniel Navaro.

Edukatorja ka rolin e regjisores pasi që ajo bën artikullimin e të gjitha aktiviteteve të cilat duhet zhvilluar, gjithë kjo duke marrë parasysh apo respektuar interesat dhe dëshirat (desires) e fëmijëve, gjithashtu ka edhe rol vëzhgues.

Sipas Navaro (2008) majeutika ka disa parime që i merr për bazë: *rëndësia e përvojës së drejtpërdrejt, të nxënit problemor, grupi dhe rëndësia e tij, edukatori në rolin e regjisorit, rregullat dhe ritet dhe programi fleksibilë*. Veçoritë të cilat e karakterizojnë këtë metodologji janë zgjidhja e konfliktit dhe krijimi i raporteve të mira (good reports). Hapësira është e krijuar në atë mënyrë që fëmijët t'i zhvillojnë aktivitetet pa pasur nevojë për ndihmë nga ana e të rriturve, ndërsa ndarja e materialit bëhet në bazë të aktiviteteve të cilat duhet zhvilluar.

- d) *Metoda e Reggio Emilia (Reggio Emilio method)* – kjo është një metodë e cila në vendin tonë ende nuk është në funksion. Sipas kësaj metodologjije fëmijët janë të lirë që të zgjedhin vetë aktivitetet, ku kështu fëmijët do të ndjehen të lirë për të eksploruar me materialet (exploration with materials) të cilat ju ofrohen.

1.1.3 Rëndësia e edukimit parashkollor (The importance of preschool education)

Bazuar në revistën ‘‘The Progressive Teacher’’ dhe në literaturën e Shaughnessy (2012) faza e edukimit parashkollor përfshinë periudhën kohore përgjatë të cilës fëmija largohet nga ambienti familjar (family environment) ku, për këtë arsye institucioni në të cilin qëndrojnë fëmijët gjatë kësaj kohe duhet të përmbajë mjete të llojllojshme edukative të cilat e tërheqin fëmijën dhe e bëjnë të ndjehet mirë e në veçanti i sigurt. Institucioni (institution) është ambienti në të cilin fëmija e mëson rëndësinë e shumë gjërave, si: rëndësinë e mikut/mikes, rëndësinë e komunikimit

me ta apo me edukatoret etj... Hulumentimet e shumta dhe specialistët e ndryshëm të edukimit tregojnë se fëmijët e kanë shumë më të lehtë të mësojnë gjëra të reja kur ata janë në kontakt ose bashkëveprojnë me bashkëmoshatarët si dhe kur edukatoret apo prindërit sillen me ta në mënyrë të këndshme (joyful way). Në këtë mënyrë, aftësitë sociale (social ability) të tyre bëhen më të mirëfillta, sjelljet poashtu e mbi të gjitha bëhet zhvillimi i mirëfilltë i personalitetit (personality) të fëmijëve.

Literatura e shtjelluar si ajo e Ali et al. (2018), Guz (2016), Shaughnessy (2012), Kleyn (2012), ku të gjithë këta pohojnë se disa nga karakteristikat dhe objektivat kryesore në edukimin parashkollor janë:

- Edukimi parashkollor është një fillim i mirë për të mësuar
- Është periudha kur bëhet zhvillimi i gjuhës dhe aftësive matematikore
- Mundësi për të rritur aftësinë e komunikimit
- Loja është mënyra përmes të cilës mësohet
- Rrugë përmes të cilës fëmijët mësojnë edhe në vitet pasuese të jetës
- Bashkëveprimi mes grupeve të fëmijëve i cili ndikon në përmirësimin e aftësive kognitive
- Zhvillimi i aftësive motorike
- Kuptimi mbi atë se gjërat e caktuara si qantat, këpucët apo dicka tjetër se kujt i takojnë
- Fëmijët mësojnë rëndësinë e kohës etj.

Për një edukim të lehtë dhe të mirë natyrisht rol të madh luajnë edhe mjedisi në të cilin qëndrojnë edukatorja dhe fëmijët (childrens), poashtu edhe mundësitë që ofron ai mjedis apo dhoma ku qëndrojnë fëmijët.

Në revistën e lartpërmendur, gjithashtu thuhet se mjetet (kushtet) kryesore për edukim në periudhën parashkollore janë këto:

- Ambienti i pastër (clean environment)
- Edukatorja të jetë e butë gjatë të folurit (the educator being soft in speaking)
- Klasa të ketë shumë ngjyra (the class having many colors)
- Lodra nga më të ndryshmet (different toys)
- Tualet të pastër (clean toilet)

- Ujë të pijshëm (drinkable water)
- Një pjesë e caktuar për pushim (a rest corner)
- Institucioni të ketë transportin e sigurt për fëmijët (safe transport of institution for childrens)
- Karta të ndryshme të cilat përshkruajnë pemët, perimet apo kafshët e ndryshme (cards that identify fruits, vegetables or animals)
- Orar të caktuar të punës - të punohet 5 ditë të javës, 3-4 orë në ditë (fixed working hours).

Duke u bazuar në atë që u tha më lartë në lidhje me edukimin, ambientin që na rrethon, shoqërinë, mjetet dhe metodat të cilat përdoren në procesin e dukimit, në këtë punim parashtrohen më saktësisht këto pyetje:

1. Si ndikon loja në edukimin parashkollor?
2. Çfarë lojërash përdoren në mësimin e gjuhës angleze dhe a munden këto lojëra të adaptohen, modifikohen dhe aplikohen në shkolla/nivele parashkollore në Kosovë?

2. METODOLOGJIA

Ky hulumtim është zhvilluar në formën përshkruese (deskriptive). Instrumentet bazë të cilat kanë shërbyer për mbledhjen e informacioneve ishin burimet si: librat e autorëve të ndryshëm: Angela Glenn, Jacquie Cousins dhe Alicia Helps, të cilët kanë dhënë kontributin e tyre në lidhje me zhvillimin social, emocional, fizik, moral, intelektual dhe kognitiv tek fëmijët në periudhën e edukimit parashkollor dhe dispenca e autorit Mikel Koliqi.

Pastaj mbledhja e të dhënave nga artikujtë shkencor të publikuara në revista të njohura shkencore si: *Science Direct*. Publikimet e projekteve, hulumtimeve dhe punimeve të ndryshme të publikuara nga shoqata dhe organizata të njohura botërore si: *The LEGO foundation*, *Funderstanding*, dhe *UNICEF*.

Rol të veçantë gjatë këtij hulumtimi kanë pasur punimet shkencore të kryera nga profesorët e nivelit akademik, përkatësisht punimet e doktoraturës në institucione të ndryshme universitare, si p.sh në universitetin e Tiranës (Alternivat e metodologjive të edukimit parashkollor dhe aplikimi i tyre në Kosovë, Rozafa Shala, 2017) dhe në universitetin e Gjakovës (Rëndësia e lojërave dhe lodrave në zhvillimin e fëmijës, Seniha Bilalli, 2017).

3. DISKUTIMI

3.1 Loja (The play)



Fig.1. Loja me bashkëmohatarë.

Marrë nga: <https://www.google.com/search?q=edukimi+parashkollor&source>

Sipas Ginsburg (2007) loja është thelbi i zhvillimit të fëmijës (the essence of child development) si në aspektin social, emocional apo fizik. Kjo mundëson që edhe prindërit e fëmijëve të jenë gjithmonë pjesë (an integral part) përbërëse e lojës së fëmijëve të tyre. Është e rëndësishme të sigurohet një mjedis i përshtatshëm për zhvillim të lojës e cila ndihmon zhvillimin optimal (optimal development) të fëmijës. Pra, loja si mjet i rëndësishëm për zhvillim optimal të fëmijës kanë të drejtë që përgjatë edukimit parashkollor të mos bëhen dallime mes fëmijëve por që këtë mundësi të mirë zhvillimi ta gëzojnë të gjithë fëmijët, pa marrë parasysh të ardhurat ekonomike të tyre apo diçka tjetër, kjo sepse të gjithë fëmijët janë qenie unike (unique beings) dhe secili meriton që të gëzojë të mirat që ofron loja.

3.1.1 Loja në edukim të hershëm (The play in early development)

Në literaturën e organizatës ‘‘Funderstanding’’ thuhet se përgjatë periudhës parashkollore bëhet zhvillimi i aftësive të ndryshme tek fëmijët, të cilat i ndihmojnë atyre në vitet në vazhdim. Mësimi fillon në këtë periudhë dhe vazhdon edhe më tej. Dëshira për të mësuar gjatë kësaj kohe natyrisht që vjen nga aktiviteti kryesor, që është loja, përmes bashkëpunimit më moshatarë në ambientet e caktuara për edukim (facilities designated for education).

Loja u ndihmon fëmijëve që të zhvillohen në aspekte të ndryshme dhe ç’është më e rëndësishmja të mësojnë për botën e jashtme. Kur fëmijët luajnë ata kanë mundësinë të zhvillohen në fusha të ndryshme (different fields) të rëndësishme për jetën, si në atë emocionale, intelektuale, fizike apo edhe në atë sociale. Sipas Stetsenko (2015) dhe Grace Ho (2015) fëmijët përmes lojës mësojnë si bëhet puna në grupe (bashkëpunimi) dhe poashtu edhe mënyrën se si të zgjidhen konfliktet e ndryshme. Përmes lojës fëmijët e shprehin kreativitetin (creativity) e tyre dhe kuriozitetin e tyre të cilat janë dy gjëra të rëndësishme të cilat ndikojnë në fitimin e njohurive. Dy gjëra themelore të cilat kontribuojnë në mësim janë motivimi dhe interesimi i fëmijëve. Ndërlidhja e këtyre dyjave ndikon pozitivisht në procesin mësimor të tyre.

Loja në edukimin e hershëm është një element i cili ka të bëjë me marrjen e roleve, krijime imagjinative dhe besimin (Vygotski, 1978). Loja e pretenduar apo ajo imagjinative ka të bëjë me zhvendosjen e një realiteti në një ‘sikur’ drejt njerëzve apo sendeve të ndryshme (Bjorklund, 2012). Fëmijët të cilët e pëlqejnë këtë lojë, nuk kanë shumë njohuri mbi botën fizike dhe kjo i shtyn ata që t’a shtrembërojnë realitetin në mënyrë që të arrijnë qëllimet e tyre (Piaget, 1945; 1962).

3.1.2 Benefitet e lojës (Benefits of play)

Ginsburg (2007) dhe Guz (2016) pohojnë se loja u mundëson fëmijëve që të jenë krijues, të përdorin imagjinatën e tyre, aftësitë e ndryshme si ato fizike, emocionale apo njohëse. Loja ndikon pozitivisht në zhvillimin e trurit (brain development) të fëmijës, ndihmon në angazhimin dhe bashkëpunimin me njerëzit që i rrethojnë dhe me botën e jashtme në përgjithësi. Loja ndihmon eksplorimin me botën e jashtme duke ndikuar në zhvillimin e aftësive të ndryshme të

cilat fëmijët mund t'i përdorin në vitet e mëvonshme në situata të ndryshme jetësore, poashtu u mëson se si duhet punuar në grupe, si të negociojnë zgjedhjen e konflikteve.

Kur loja drejtohet nga vetë fëmijët atëherë kjo gjë mundëson që ata të mësojnë vendimmarrjen (decision), të ndjekin interesat e veta, pasionet e tyre dhe gjithashtu mundëson që ata të mësojnë rregullat që duhet ndjekur në raste të ndryshme, krijimtarinë dhe udhëheqjen. Përveç argëtimit që ofron loja, ajo poashtu ndikon në zhvillimin fizik të fëmijës, pra mundëson që fëmijët të kenë një trup të shëndetshëm (healthy body). Përgjatë lojës, të rriturit veçanërisht prindërit kanë mundësi të jenë pjesë e lojës së tyre dhe kështu përmes bashkëveprimit të tyre me fëmijët u lënë të kuptojnë që ata u kushtojnë vëmendje atyre dhe ndihmojnë në krijimin e marrëdhënieve sa më të mira.

Prindërit pra, kanë mundësi të jenë pjesë e botës së fëmijëve përgjatë lojës dhe kështu ata krijojnë mundësi të mira që fëmijët të zhvillojnë komunikimin (communication) e tyre. Thënë më mirë, ata në këtë mënyrë kanë mundësi të jenë gjithmonë të përkushtuar për fëmijët e tyre. Përveç zhvillimit emocional, ambienti shkollor ndikon edhe në zhvillimin social dhe kognitiv të fëmijës, e të gjitha këto pra, arrihen përmes bashkëpunimit me moshatarët e tyre.

Edukatorët dhe çdokush tjetër e dinë që loja si aktivitet edukativ ka dobi mjaftë të madhe për të gjitha sferat jetësore zhvillimore të fëmijëve. Pra, është një komponent me rëndësi në zhvillimin sa më të shëndetshëm të fëmijëve dhe një nga të drejtat themelore të tyre (Ligjëratë e autorizuar). Fëmijët përmes lojës mësojnë të kontrollojnë muskujt, mësojnë koordinimin, zhvillojnë koncepte të ndryshme matematikore përmes përdorimit të formave ose figurave të ndryshme. Përmes lojës, fëmijët e zhvillojnë empatinë, përdorimin e shqisave dhe shprehjen e emocioneve të tyre (Ligjëratë e autorizuar).

Loja ndihmon që fëmijët të kuptojnë që gjërat duhet të ndahen me të tjerët e veçanërisht me bashkëmoshatarët e tyre të mësojnë të kontrollojnë impulsjet dhe veprimet e tyre. Rëndësia e lojës ka të bëjë edhe me atë se fëmijët gjatë zhvillimit të lojës reduktojnë agresivitetin, zhvillojnë fleksibilitetin, rrisin kreativitetin, imagjinatën dhe pasurojnë fjalorin e tyre. Loja ka vlera morale (moral value) për shkak se ajo i mëson fëmijët mbi të vërtetën, integritetin dhe përgjegjësinë (Ligjëratë e autorizuar).

3.1.3 Historiku i lojës (History of play)

Në studimin “Rëndësia e lojërave dhe lodrave në zhvillimin e fëmijës” (Bilalli, 2017) thuhet se qysh në kohën e filozofëve grekë, loja shihet si një nga mënyrat më interesante përmes së cilës fëmijët e tregojnë shpirtin e tyre dhe mbi të gjitha definohen si fëmijë.

Schiller – i thekson se loja është një nga aktivitetet fizike, mentale dhe simbolike dhe se një fëmijë është i kompletuar përmes lojës. Ndërsa Frobel - i tregon se loja është niveli më i lartë në procesin e zhvillimit të fëmijëve si dhe aktiviteti më i natyrshëm i cili promovon fëmijët.

Përgjatë kohës kanë ndryshuar shumë gjëra, ndër to edhe forma e të jetuarit mirëpo loja ka qenë gjithnjë pjesë e jetës së fëmijëve (part of the lifes of childrens). Dhe për këtë arsye loja ka qenë një nga qëllimet kryesore të autorëve të ndryshëm për t’a studiuar rëndësinë e saj.

3.1.4 Teoritë mbi lojën (Theories of play)

Disa teori mbi lojën janë këto:

Teoria e Energjisë së Tepërt - Surplus energy (Schiller 1873; Spencer 1875)

Sipas kësaj teorie loja është rezultat i energjisë së tepërt (excess energy) që e posedon fëmiju pasi që ai nuk ka përgjegjësi të tjera sikurse të rriturit, ai këtë energji duhet ta lirojë përmes lojës. Pra, kjo teori tregon se si për mbijetesë apo për punë energjia është shumë e rëndësishme. Pra, duke parë që fëmijët nuk kanë obligime rreth mbijetesës ata e lirojnë energjinë përmes lojës (Ligjëratë e autorizuar).

Teoria e Relaksimit (Qetësimit) - Relaxation theory (Lazarus 1883; Patrick 1916)

Sipas kësaj teorie organizmi ballafaqohet me detyra të shumta dhe kështu rikthimi i energjisë (energy recovery) bëhet përmes lojës, e në këtë mënyrë individi e kalon kohën më të madhe të kohës në lojë (Ligjëratë e autorizuar).

Teoria e Para – ushtrimit - Pre-exercise theory (Groos 1898)

Loja është forma e cila i'u mëson sjelljet fëmijëve dhe është thelbi për një mbijetesë në vitet e mëvonshme. Pra, loja e përgaditë fëmijën për vitet në vazhdim. Rëndësia e kësaj teorie qëndron në faktin se zhvillimi i aftësive intelektuale dhe kognitive (intellectual and cognitive abilities) arrihen përmes lojës (Ligjëratë e autorizuar).

Teoria e Plotësimit të Ego-së - Ego expanding theory (Lange 1902; Claparde 1911)

Loja është një formë normale e plotësimit apo ushtrimit të egos apo pjesëve të tjera të personalitetit, ushtrim ky i cili mundëson zhvillimin e aftësive njohëse (cognitive abilities) dhe shfaqjen e aftësive të tjera (Ligjëratë e autorizuar).

Në librin “Loja dhe të nxënit në moshën e hershme” të autorëve: Angela Glenn, Jacquie Cousins dhe Alicia Helps theksohet se për lojën ekzistojnë edhe këto teori:

Teoria e Socio-Kulturës - Socio-cultural theory (Vygotsky 1977 – 1978)

Kjo teori thekson rëndësinë e ndërveprimit social (social interaction) në zhvillimin e fëmijës. Sipas kësaj teorie loja është aktiviteti më i rëndësishëm në moshën parashkollore pasi që të gjitha zhvillimet psikologjike arrihen përmes lojës. Vygotsky tregon rëndësinë e “zonës së proksimitetit” e cila definohet si dallimi në mes të asaj se çka mundet të bëj vetë fëmiju dhe asaj se çka bën në rast se i ofrohet ndihmë.

Teoria e Evolucionit - Evolution theory

Kjo teori ka japë të dhëna të shumta bazuar në mënyrën (the way) e zhvillimit të fëmijëve. Kjo kishte të bënte me fëmijët e posalindur, me formën përmes së cilës ata rriten dhe bëhen më të zhvilluar. Kështu, loja filloi të konsiderohej një nga format më të rëndësishme përmes së cilës fëmija mëson dhe rritet.

Loja dhe rritja e inteligjencës (The game and the expansion of intelligence)

Këtë teori e ka krijuar Piazhe (Jean Piaget) i cili ka vëzhguar në vazhdimësi zhvillimin e fëmijëve dhe thoshte se loja lidhet me rritjen e inteligjencës së fëmijëve. Në këtë ndikojnë dy proceset e rëndësishme: akomodimi dhe asimilimi (accommodation and assimilation). Në

mënyrë që të nxënit e fëmijës të ketë efekt, atëherë këto dy procese duhet të jenë në ndërveprim të vazhdueshëm. Kështu që, fëmiu çdoherë dëshiron që ato informacione të cilat i merr, t'i kuptojë dhe t'i lidhë ato me ndonjë informatë që ka marrë më herët. Në rast se këto dy procese të rëndësishme nuk janë në ndërveprim, atëherë, kjo sjellë në përfundim imitimim (imitation), e në këtë rast, fëmijët mundohen që të kuptojnë një ndodhi në formën që ai di vet.

3.1.5 Përmbajtja e lojës (Content of the game)

Për të zhvilluar një lojë ajo duhet të plotësojë disa kritere, si:

- Loja duhet të jetë e pëlqyeshme nga ana e fëmijës
- Loja duhet të jetë motivuese, pra, duhet të sjellë kënaqësi
- Loja zgjedhet lirshëm, në mënyrë vullnetare në të kundërtën fëmijës nuk do t'i duket se është duke luajtur
- Loja duhet të angazhojë fëmijët në mënyrë aktive, si fizikisht poashtu edhe mendërisht (Ligjëratë e autorizuar).

Përmbajtja e lojës ka të bëjë me aspekte të ndryshme fizike si dhe me ndërveprim social.

Fushat në të cilat loja ndikon në stimulim janë:

- ✓ rritja e kreativitetit (increased activity)
- ✓ inkurajimi i pjesëmarrjes (encouraging participation)
- ✓ përmirësimi i memories (memory improvement)
- ✓ stimulimi i gjuhës (language stimulation)
- ✓ pasurimi i imagjinatës (enriching the imagination)
- ✓ zhvillimi i bashkëpunimit (development of cooperation).

Në mënyrë që fëmijët të mësohen të luajnë, duhet:

- ✓ të jemi kreativ në zhvillimin e lojës
- ✓ të sigurojmë mjedisin e duhur për lojë
- ✓ të kemi llojllojshmëri të lodrave
- ✓ të kujdesemi që fëmijët mos të lodhen

- ✓ të vëzhgojmë fëmijët për të kuptuar a kanë nevojë për ndihmë si dhe
- ✓ trajnim i gjatë i tyre në mënyrë që aftësitë të qëndrojnë (Ligjëratë e autorizuar).

3.2 Gjashtë fazat e lojës – Six stages of the game (sipas Parten dhe Newhall)

Përgjatë periudhës së fëmijërisë së hershme ekzistojnë disa faza përgjatë të cilave fëmijët preferojnë lojëra nga më të ndryshmet. Këto faza janë të shtjelluara si më poshtë:

Loja e lirë (free game) - gjatë kësaj faze fëmijët nuk angazhohen ose përfshihen në mënyrë aktive por luajnë me të gjithë dhe me çdo gjë. Fëmijët rrinë në vend ose mund të lëvizin në mënyrë të paqëllimshme. Kjo fazë përfshinë fëmijët që nga lindja deri në 6 muaj (Ligjëratë e autorizuar).

Loja e vetmuar (the lonely game) - në këtë fazë fëmijët luajnë vetëm duke pasur edhe lodrat e ndryshme prej të tjerëve dhe nuk u intereson se çfarë janë duke bërë të tjerët. Kjo fazë përfshinë fëmijët e moshës 6 muaj deri në 18 muaj. Kjo mënyrë e lojës u mëson fëmijëve se si të argëtojnë vetveten (Ligjëratë e autorizuar).

Loja si spektator (the game as a spectator) - kjo është kur fëmija nuk i bashkohet lojës edhe pse sheh se të tjerët janë duke luajtur. Kjo formë e lojës ndodh nga 18 muaj deri në moshën 3 vjeçare por mendohet se ndodh në çdo moshë tjetër (Ligjëratë e autorizuar).

Loja paralele (the parallel game) – kjo lojë realizohet në rastet kur fëmijët janë përkrahë njëri-tjetrit por që ka një mungesë të përfshirjes mes tyre. Luajnë me lodra të ngjashme por nuk i ndajnë ato me njëri-tjetrin. Kjo lojë realizohet tek fëmijët e moshës 3 dhe 4 vjeç, por ndodh edhe tek moshat tjera (Ligjëratë e autorizuar).

Loja shoqëruese (the accompanying game) – në këtë fazë fëmijët luajnë bashkë mirëpo nuk kanë ndonjë qëllim të përbashkët. Ata përdorin lodrat e njëjta, bashkëpunojnë me njëri-tjetrin por që loja nuk ka rregulla të caktuara. Kjo lojë ndodh nga moshë 3 deri në moshën 4 vjeçare dhe vazhdon edhe në moshën parashkollore. Përmes kësaj fëmijët mësojnë bashkëpunimin, si të zgjidhin problemet dhe pasurojnë fjalorin (Ligjëratë e autorizuar).

Loja bashkëpunuese (the cooperative game) – gjatë kësaj faze fëmijët i zhvillojnë bashkë aktivitetet, përcaktojnë rregullat dhe qëllimet. Kjo lojë mendohet se nuk ndodh shpesh para

moshës 4 vjeçare po që kjo mund të ndodh edhe para kësaj moshe dhe vazhdon deri më moshën 5 vjeçare (Ligjëratë e autorizuar).

3.2.1 Qëllimet e lojës (Goals of the game)

Në studimin “Rëndësia e lojërave dhe lodrave në zhvillimin e fëmijës” (Bilalli, 2017) gjithashtu thuhet se fëmijët duke filluar nga lindja mësojnë vazhdimisht duke përdorur kështu të gjitha aftësitë që ata kanë, për të kuptuar gjithçka që ata i rrethon. Pra, përgjatë kësaj periudhe loja është aktiviteti kryesor përmes së cilës ata mësojnë duke pasur për bazë këto dimensione zhvillimi (developmental dimensions):

- Zhvillimi social/emocional – fëmijët duke bashkëvepruar me të tjerët ata mësohen që të bashkëpunojnë, të mësojnë përvoja të reja në jetën e tyre, të kuptojnë emocionet e të tjerëve, të zhvillojnë kreativitetin, imagjinatën dhe përgjegjësinë.

Bashkëveprimi i cili bëhet ndërmjet fëmijëve ka rëndësi të madhe në zhvillimin social (social development) të tyre. Kështu ata fillojnë të kuptojnë emocionet e shokut/shoqes, fillojnë të mësojnë përgjegjësinë, kreativitetin, shprehjen e dëshirave apo nevojave të tyre dhe sigurinë. Loja u mundëson fëmijëve që të mos kenë frikë, të rrisin vetbesimin gjë që i’u ndihmon në kapërcimin e sfidave të ndryshme që i’u ofron jeta dhe u mundëson shprehjen e ndjenjave pa pasur nevojë për të gënjyer.

- Zhvillimi fizik dhe motorik – kur fëmijët luajnë ata janë në lëvizje vazhdimisht, vrapojnë, kapën, hidhen. Në këtë mënyrë fëmijët pavarësohen dhe bëhen më të aftë për të kryer detyrat nga më të ndryshmet.

Secili fëmijë posedon formën (stilin) e vet të zhvillimit. Me kalimin e kohës mund të vërehet se kur një fëmijë nuk ka qenë në gjendje të gjuajë topin apo një objekt të caktuar, pasi të rritet do të shohim se ai do t’a bëjë më mirë gjuajtjen.

Është e domosdoshme që fëmijëve t’u jepet më shumë kohë që të luajnë lojëra të ndryshme sepse në këtë mënyrë ata do t’i vënë më shumë në funksion muskujt e tyre, do të bëjnë më shumë vrapim (run), kërcim (jump), hedhje (sprinkle) dhe kështu do të marrin pjesë nëpër gara të llojllojshme.

Përmes lojës fëmija e bën një sjellje shumë më lirshëm sesa kur atij i kërkohet një gjë e tillë në raste të ndryshme. Përmes lojës fëmijët kanë trupin më të shëndetshëm dhe nuk kanë problem me mbipeshë.

- Zhvillimi i gjuhës/komunikimit – përmes lojës fëmijët sigurisht që e pasurojnë fjalorin dhe kështu ata zhvillojnë aftësitë e shprehjes së mendimeve apo ndjenjave (the ability to express opinions or feelings) si dhe bashkëveprimin me të tjerët.
- Zhvillimi kognitiv dhe njohuritë e përgjithshme – është e domosdoshme që fëmijët të kuptojnë gjithçka rreth botës që ata i rrethon sepse në këtë mënyrë ata kuptojnë lidhjet që mund të kenë ndodhitë e ndryshme me objektet dhe mësojnë edhe si bëhet zgjidhja e problemeve (problem solving). Loja dhe mësimi kanë një lidhje të pashmangshme, kështu edhe loja me të zhvilluarit kognitiv. Zhvillimi intelektual ka të bëjë me të menduarit dhe të arsyetuarit. Loja ka të bëjë me mësimin e shkrimit, leximit, numrave, prekjes etj... Vendimmarrja, koncentrimi, të menduarit kanë të bëjnë, pra, me zhvillimin intelektual dhe gjuhësor të fëmijës (linguistic and intellectual development).
- Qasja ndaj të mësuarit – inkurajimi (encouraging) dhe mundësitë të cilat ofrohen gjatë edukimit të fëmijës kanë rëndësi të madhe. Në këtë mënyrë ata janë më të interesuar për pjesëmarrje në lojë dhe bëhen më të suksesshëm në forma të ndryshme.

3.2.2 Loja në mendimin pedagogjik (The game in pedagogical thought)

Në dispencën ‘‘Loja në mendimin pedagogjik’’ të autorit Mikel Koliqi (2010) thuhet se loja është një nga kontekstet e të nxënit përmes të cilës fëmijët kërkojnë të njohin botën në të cilën ata gjenden. Rëndësia e lojës ka qenë gjithmonë pjesë e mendimit pedagogjik (pedagogical thinking) duke filluar kështu nga Froebel – i dhe pedagogjia idealiste të cilët e shohin lojën si një nga veprimtaritë kryesore të fëmijërisë. Piaget tregon se si fëmija e prezanton veten tek bota e jashtme dhe se si e kontrollon atë, veçanërisht në shtatë vitet e para të jetës fëmija përgjatë lojës përdorë mendimin egocentric, pra, i përshtatë dëshirat e veta me përvojat e fituara duke i dhënë kuptim mendimeve apo simboleve të tij të cilat paraqesin bazën në botën ku ai jeton.

Vigotsky tregon se fëmijët përgjatë lojës i përdorin në maksimum aftësitë apo njohuritë e tyre. Poashtu, tregon se ekziston një hapësirë e zhvillimit e cila ka të bëjë me atë se çka është në gjendje të bëjë fëmija vetëm dhe çka bën nëse ndihmohet nga një i rritur. Në këtë hapësirë fëmija

imiton gjithçka që sheh, zhvillon krijimtarinë, pra, aftësinë e tij për të kombinuar elementet e ndryshme që në fakt nuk kombinohen fare. Kjo ka të bëjë me atë se në lojë veprimi kërkohet dhe është i qëllimshëm dhe më tepër motivohet nga kuptimi se sa nga objektet e ndryshme dhe se fëmija vepron brenda situatave imagjinate por krejtësisht të pavarura nga situatat e përceptuara.

Erikson-i thekson rëndësinë e lojës si një formë e përforcimit të identitetit (identity reinforcement). Përmes lojërave pozitive apo negative fëmija krijon identitetin e vet, pra, unin i cili përfaqëson secilin fëmijë në jetën e vet.

3.2.3 Loja dhe edukimi (The play and education)

Është shumë e rëndësishme që t'i mësojmë fëmijëve se çka ofron shkolla apo shoqëria në përgjithësi. Kjo u mundëson atyre të kuptojnë më shumë rreth shkollës e në veçanti jetës, u mundëson të kuptojnë koncepte të ndryshme (different concepts), të zhvillojnë më pas aftësitë e tyre ose edhe të krijojnë ide të reja nga më të ndryshmet (Winthrop & McGivney, 2016; Fisher, 2016).

Në dispencën e lartpërmendur thuhet se për ta kuptuar më hollësisht rëndësinë e lojës në jetën e fëmijës duhet t'iu kushtojmë vëmendje disa pikëpamjeve. Pikëpamja e parë ka të bëjë me disa kategori:

1. Kategoria funksionale (functional category) – kjo tregon se fëmija luan me gjymtyrët e tij të trupit, përkatësisht kapet, vrapon, ecë, pra, kjo lidhet me dëshirën për të lëvizur pavarësisht nëse ka apo nuk ka mjete të lojës.
2. Kategoria simbolike (symbolic category) – kjo ka të bëjë me imitimin ose observimin e fëmijës përgjatë lojës, gjë që u mundëson fëmijëve që të mësojnë aspekte të ndryshme simbolike.
3. Kategoria e shoqërimit (the companion category) – kjo ka të bëjë me ndërveprimin me të tjerët në të cilën ndikojnë disa elemente si: dëshira për të bërë gjëra sikur të rriturit, kërkesa për bashkëpunim, dhe dëshira për sukses.

Pikëpamja e dytë lidhet më të kuptuarit e aktiviteteve. Ne duhet që përmes aspekteve të ndryshme psikologjike apo pedagogjike të tregojmë se çka shohim apo observojmë tek fëmijët dhe se këto aspekte të përkrahin mënyrën e edukimit e cila ka të bëjë me rritjen dhe të kuptuarit e

botës që i rrethon ata. Kjo bëhet duke qenë në të sigurt për kohën dhe vendin ku punojmë dhe kahjen në të cilën e drejtojmë fëmijën. Pikëpamja e tretë lidhet së pari me zhvillimin fizik të fëmijës, zhvillimin intelektual dhe me zhvillimin kognitiv të fëmijës.

3.2.4 Loja dhe të mësuarit gjatë gjithë jetës (The play and lifelong learning)

Sipas (e.g. Care, Kim, Anderson, & Gustafsson – Wright, 2017; Deci & Ryan, 2000;2012; Dignath, Buettner, & Langfeldt, 2008; Harvard CDC, 2011) në kohën e tanishme në jetojmë dhe veprimet sipas mënyrave të cilat nuk kanë ekzistuar kohë më parë, kjo për shkak të arritjes së teknologjisë. Secili fëmijë ka nevojë që të zhvillojnë të menduarit, të zhvillojnë aftësitë e tyre, të krijojnë mundësitë të mira si për veten poashtu edhe për shoqërinë, si dhe që të mësojnë përgjatë gjithë jetës gjëra të reja. Edhe pse njerëzimi dallon në bazë të kulturës apo edhe në bazë të konteksteve tjera, ajo çka ka rëndësi të madhe janë mundësitë që ofrohen për të mësuar pasi që këto përbëjnë rolin kryesor të të mësuarit.

Gjatë lojës fëmijët kanë rastin që të zhvillojnë çdo aftësi, dhe përveç se kanë mundësinë që të argëtohen pa masë (limitless fun), fëmijët poashtu zhvillojnë aftësinë e bashkëpunimit me të tjerët dhe çka është më kryesorja aftësinë e të komunikuarit. Përveç kënaqësisë që ofron loja, ajo poashtu u ndihmon fëmijëve në zhvillimin e aftësive të cilat do u nevojiten secilit fëmijë në jetën e tyre. Pra, kjo do të thotë se eksperiencat e ndryshme në lojë u ndihmojnë fëmijëve që ata të rriten shëndetshëm në jetën e tyre dhe të jenë fëmijë që mësojnë gjatë gjithë jetës.

3.3.5 Kënaqësia është çelësi i lojës (Joy is the key of play)

Kënaqësia në përgjithësi ka të bëjë me ndjenja positive (positive feelings) të cilat ofrohen gjatë lojës. Mirëpo kjo nuk do të thotë që nuk mund të ketë edhe emocione negative. Në disa raste kur kemi ndonjë problem në fund arrihet kënaqësia pas zgjidhjes së atij problemi. Kënaqësia lidhet me motivimin dhe interesin e fëmijës (motivation and interest of the child). Janë bërë studime mbi motivimin dhe koncepteve tjera si mentaliteti (Dweck, 2006) si dhe konceptit tjetër që është kurajo (Duckworth, 2016). Studiues të ndryshëm kanë treguar se përvojat negative në jetë ndikojnë në pengesa të ndryshme gjatë të mësuarit ndërsa ato pozitivet ndikojnë që të tejkalohen

sfidat e ndryshme në jetë. Poashtu edhe të tjerë studiues theksojnë se kënaqësia lidhet ngushtë me të menduarit, të krijuarit dhe të motivuarit.

3.3 Të mësuarit në zhvillimin e aftësive (Learning to learn skills)

Mësimi i aftësive kërkon shumë kohë dhe sigurisht edhe mirëkuptim të thellë. Të mësuarit e aftësive lidhet me të mësuarit e shumë informacioneve të cilat u ndihmojnë fëmijëve që të mësojnë rreth aftësive të ndryshme, të fitojnë ndonjë aftësi dhe në bazë të këtyre informacioneve ata të i'a dalin të merren me situata të ndryshme që u ofron jeta (e.g. Care, Kim, Anderson, & Gustafsson – Wright, 2017; Deci & Ryan, 2000;2012; Dignath, Buettner, & Langfeldt, 2008; Harvard CDC, 2011). Kjo poashtu ka të bëjë edhe me të motivuarit e fëmijës, rritjen e kureshtjes dhe çka është më e rëndësishmja dëshirën për të mësuar. Për më tepër, mësimi i aftësive ndihmon fëmijët që të jenë këmbëngulës, të jenë vetvetja, dhe të përcaktohen ndaj një qëllimi.

Është e rëndësishme që fëmijët të përgaditen sa më mirë, në mënyrë profesionale ose shkencore dhe pasiqë ne jetojmë në një botë të madhe shoqërore ata duhet mësuar që të kenë kontakt me të tjerët në mënyrë sa më paqësore (contact with others peacefully). Çdo fëmijë është më i suksesshëm, më bashkëpunues kur kanë më shumë kontakt me të tjerët (Jones, Greenberg, & Crowley, 2015).

3.3.1 Ndërlidhja e fushave zhvillimore jetësore të fëmijëve (Child development is interconnected)

Në literaturën e shtjelluar të organizatës “Lego Foundation” përmendet se zhvillimi i fëmijëve ndërlidhet me fusha të ndryshme, pra, kjo do të thotë se një fushë e zhvillimit ndikon në fushën tjetër zhvillimore. P.sh.: zhvillimi fizik lidhet me të zhvilluarit e aftësive shoqërore dhe kognitive. Studiues të ndryshëm kanë theksuar se një të fëmijë mëson të ecë pas zvarritjes, më pas ai kërkon kujdestarin e tij dhe dëshiron që të bisedojë apo të luajë me të. Poashtu edhe të tjerë studiues kanë treguar që aftësitë sociale dhe mënyra e rregullimit të emocioneve, të dyja, mbështesin aftësitë kognitive të fëmijëve kurse theksojnë se gjuha u ndihmon atyre që të kenë kontakt në mënyrë pozitive mes vete.

3.3.2 Përdorimi i lojës për të ndihmuar fëmijët me vështirësi emocionale (The usage of play to help children to overcome emotions)

Në librin “Loja dhe të nxënit në moshën e hershme” theksohet se edukatorët të cilat punojnë në institucione parashkollore kanë pasur ose do të kenë në të ardhmen situata në të cilat fëmijët do të kenë përjetuar ndonjë ngjarje në familje, kanë humbur dikënd apo ndonjë gjë tjetër. Kështu, shumë nga ne nuk e dimë se cila do të ishte njëra nga format më të mira për t’i ofruar ndihmë atyre fëmijëve. Pra, në këtë mënyrë ne duhet të ofrojmë mundësi të mira për shprehjen e emocioneve (expression of emotions) të fëmijëve në bazë të lojërave që organizojmë brenda institucionit. Gjithashtu edhe mbështetja e të rriturve luan rol mjaftë të rëndësishëm në shprehjen e emocioneve apo shqetësimeve që mund të kenë fëmijët.

Secili fëmijë shqetësimet e veta mundet t’i shprehë në forma nga më të ndryshmet: qanë, nuk ka dëshirë që të luajë me fëmijët e tjerë, ka ankthe vazhdimisht, nuk mund të shprehet, nuk hanë ushqim e të tjera. Atëherë, nëse shohim tek fëmijët ndonjëherë nga këto simptoma është e domosdoshme që të vëzhgohet loja e tyre në mënyrë që të kuptojmë se në çfarë mënyre mundemi t’i ndihmojmë këta fëmijë. Në bazë të kësaj ne japim të dhëna të sakta tek specialistët e edukimit të cilët ndoshta më vonë do t’u duhej që të përfshiheshin në këtë situatë.

Disa nga mënyrat e lojërave të cilat mund të ndihmojnë në këto raste janë këto:

- ✚ Karnevalet
- ✚ Tregimet e ndryshme
- ✚ Veglat muzikore
- ✚ Arti
- ✚ Drama etj.

3.3.3 Lojërat përmes të cilave mund mësohet një gjuhë e huaj (*Learning foreign languages based in games*)

Loja ofron mundësi të shumta për mësimin e një gjuhe të huaj, ‘‘ajo ndihmon synimin e përdorimit të një gjuhë në jetë’’ (Lewis and Bedson, 1999: 5). Në varësi të llojit të gjuhës së huaj e cila mësohet, lojërat mund të ndahen në lojërat e komunikimit dhe lojërat e kontrollit (Brewster et al. 1992; 2002).

Në bazë të asaj që u tha më lartë në lidhje me të mësuarit e gjuhës së huaj, më poshtë janë të përshkruara dhe të emëruara disa lojëra të thjeshta përmes të cilave mund të mësohet një gjuhë e huaj, p.sh., gjuha angleze.

1. Fjalëkryqi (scrabble)

Kjo lojë përmbanë një fjalëkryq e cila fillon me katër deri në dymbëdhjetë shkronja. Kjo lojë është krijuar nga Hasbro. Ky fjalëkryq ka deri në 100 pllaka përmes të cilave formohen fjalë nga më të ndryshmet. Çdo fjalë e cila formohet nga ky fjalëkryq përmbanë pikët e caktuara dhe sa më e gjatë të jetë fjala aq më shumë pikë do të grumbullohen.

2. Kloo



Kjo është një lojë edukative e cila realizohet me disa letra. Kjo lojë përmbanë dy kuti me letra dhe me letrat të cilat merren në dorë në bazë të tyre formohet fjala, pra, fjala formohet vetëm me shkronjat të cilat gjenden në letrat të cilat i kemi në dorë.

Fig. 2. Loja Klooo

3. Shënjimi (spot it)



Fig. 3. Loja Shënjimi (Spot it)

Kjo është një lojë përmes së cilës mësohen fjalë nga më të ndryshmet të cilat kanë të bëjnë me ushqim, veshmbathje apo edhe me kafshë. Për këtë lojë nevojiten dy kutia, njëra kuti duhet të jetë me fjalë ndërsa tjetra me simbolet (figurat) e atyre fjalëve. Fjala e cila tërhiqet nga kutia duhet të përshtatet me simbolin e saj e cila gjendet në kutinë tjetër.

4. KONKLUDIME DHE REKOMANDIME

Në bazë të shtjellimit të literaturës konkludohet se rëndësia e kësaj periudhe është shumë e madhe ku kjo ndikon në bashkëpunimin e faktorëve kyç në edukimin sa më të mirë të fëmijëve. Kjo gjithashtu bën të mundur bashkëpunimin e fëmijëve mes vete e në këtë mënyrë fëmijët e kanë më të lehtë të mësojnë gjëra të reja kur janë në kontakt me bashkëmoshatarët e tyre.

Në bazë të pyetjes së parë e cila kishte të bënte me ndikimin e lojës në edukimin parashkollor, konkludohet se loja është aktiviteti kryesor në arritjen e qëllimeve gjatë periudhës parashkollore. Kjo pra, ndikon në zhvillimin e aftësive të ndryshme tek fëmijët duke filluar nga rritja e motivimit apo interesimit të fëmijëve. Loja ndikon edhe në mësimin e punës në grupe, zgjidhjen e konflikteve, zhvillimin intelektual, emocional e fizik, e në veçanti eksplorimin me botën e jashtme dhe kuptimin e jetës duke bërë që të mësohen koncepte të ndryshme të cilat u nevojiten fëmijëve në vazhdimësi.

Pyetja e dytë kishte të bëjë me lojërat të cilat mund të përdoren në mësimin e gjuhës angleze, e kështu arrihet të shihet se disa nga lojërat të cilat mund të përdoren në mësimin e kësaj gjuhe janë : Kloo, Scrabble dhe Spot it. Këto munden të modifikohen, adaptohen dhe aplikohen edhe në shkolla/nivele parashkollore në Kosovë. Gjithë kjo duke i'u përshtatur moshës së fëmijëve, dëshirës, disponimit, nevojës dhe momentit për tu aplikuar.

Duke u nisur nga kjo që u tha më lartë, rekomandohet që:

- Periudha kohore përgjatë të cilës edukohen fëmijët të merret me seriozitet dhe të punohet në vazhdimësi në të mirë të fëmijëve.
- Të modifikohen dhe të adaptohen lojërat që përdoren për mësimin e gjuhës angleze si Kloo, Scrabble, dhe Spot it, edhe për mësimin e gjuhës amtare.
- Të krijohet një ambient jokërcënues, miqësor i ngrohtë, me mundësi të aplikimit të lojërave që nuk kërkojnë kosto të lartë, por që zhvillojnë aspektin kognitiv, emocional, intelektual dhe fizik të fëmijës, dhe

- Edukatorët përgjatë zhvillimit të aktiviteteve të ndryshme të marrin parasysh hapësirën e nevojshme për zhvillimin e lojërave, dëshirat dhe interesat e fëmijëve dhe materialet të cilat nevojiten për zhvillim të këtyre aktiviteteve.

Duket shumë qartë se periudha parashkollore është mjaftë kritike e cila kontribuon në edukimin sa më të mirë të fëmijëve por që njëkohësisht mundëson zhvillimin e aftësive të ndryshme. Duke marrë parasysh faktin se loja është forma kryesore në arritjen e qëllimeve kryesore atëherë duhet kushtuar shumë rëndësi gjendjes se përgjithëshme emocionale të fëmijëve, moshës dhe hapësirës e cila është një plus në zhvillimin sa më të lehtë të aktiviteteve edukative dhe arritjes së qëllimeve të ndryshme.

Referencat

- Ali** , E., M. Constantino K., Hussain A., Akhtar Z. (2018). The Effects of Play – Based Learning on Early Childhood Eduaction and Development. *J. Evolution Med. Dent. Sci.* 2018;7(43). DOI: 10.14260/jemds/2018/0000DOI: 10.14260/jemds/2018/1044.
- Bilalli**, S., (2017). Rëndësia e Lojërave dhe Lodrave në Zhvillimin e Fëmijës. *Punim Doktorature*. Universiteti i Gjakovës “ Fehmi Agani”, Fakulteti i Edukimit.
- Björklund**, David F. 2012. Children’s thinking: Cognitive development and individual differences. Belmont: Wadsworth Cengage Learning.
- Brewster**, Jean, Gail Ellis, and Denis Girard. 1992. The primary English teacher’s guide. Harlow: Pearson Education.
- Brewster**, Jean, Gail Ellis, and Denis Girard. 2002. The primary English teacher’s guide. New edition. Edinburgh: Pearson Education.
- Boyle**, S. (2011). Teaching Toolkit: An Introduction to Games Based Learning. UCD Dublin, Ireland: UCD. *Teaching and Learning Resources*. Retrieved from <https://www.ucd.ie/t4cms/UCDTLT0044.pdf>.
- Care**, E., Kim, H., Anderson, K., & Gustafsson-Wright, E. (April 2017). Skills for a Changing World: National Perspectives and the Global Movement. Center for Universal Education at Brookings.
- Deci**, E. L., & Ryan, R. M. (2000). The” what” and” why” of goal pursuits: Human needs and the selfdetermination of behavior. *Psychological inquiry*, 11(4), 227-268.
- Deci**, E. L., & Ryan, R. M. (2012). Motivation, personality, and development within embedded social contexts: An overview of self-determination theory. *The Oxford handbook of human motivation*, 85-107.

- Dignath, C., Buettner, G., & Langfeldt, H.-P.** (2008). Hoë can primary school students learn self-regulated learning strategies most effectively? *Educational Research Review*, 3(2), 101–129.
- Duckworth, A.** (2016). *Grit: The power of passion and perseverance*. New York, NY: Simon & Schuster.
- Dweck, C. S.** (2006). *Mindset: The new psychology of success*. New York: Random House.
- Ginsburg, K.** (2007). The Importance of Play in Promoting Healthy Child Development and Maintaining Strong Parent-Child Bonds. *American Academy of Pediatrics. Clinical Report*. 119 (1). pp. 12.
- Glenn, A., Cousins, J., & Helps, A.**, (2006). Strategji të Provuara dhe Testuara: Loja dhe të Nxënë të Moshën e Hershme. *Albania. Save the Children*.
<https://albania.savethechildren.net/sites/albania.savethechildren.net/files/library/.pdf>
- Guz, E.**, (2016). PhD - Department of Applied Linguistics, Institute of English Studies. Learning a Foreign Language Through Play. Doi: <http://dx.doi.org/10.18290/rh.2016.64.11-3>.
- Houghton, E., Aston, H., Featherstone, G., Perrotta, C., Houghton, E., & Aston, H. et al.** (2013). *Game-based Learning: Latest Evidence and Future Directions*. Slough: Research Programme: Innovation in Education). Retrieved from
<https://www.nfer.ac.uk/publications/GAME01>
- Jones, D. E., Greenberg, M., & Crowley, M.** (2015). Early Social-Emotional Functioning and Public Health: The Relationship Between Kindergarten Social Competence and Future Wellness. *American Journal of Public Health*, e1–e8. <http://doi.org/10.2105/AJPH.2015.302630>
- Kaushik, P., & Marwaha, R.**, (2014). Importance Of Pre School Education. *The Progressive Teacher*. <https://www.progressiveteacher.in/importance-of-pre-school-education>.
- Koliqi, M.**, (2010). “Loja” në Mendimin Pedagogjik *Shisalbania*.
<http://www.shisalbania.org/media/5acbade18d7fa.pdf>

- Lewis, Gordon, and Günther Bedson.** 1999. Games for children. Oxford: Oxford University Press.
- Lipoff, S.,** (2011). History of Early Childhood Education. *Funderstanding*.
<https://www.funderstanding.com/educators/history-of-education>.
- Miftari, J.** (2017). S. Shkathtësitë e Komunikimit me Fëmijët. Ligjeratë e autorizuar. *Universiteti i Mitrovicës “ Isa Boletini”, Fakulteti i Edukimit*. Mitrovicë.
- Montessori, M.,** Montessori Theory. *Daily Montessori*.
<http://www.dailymontessori.com/montessori-theory/>.
- Navaro, D.** (2008). Majeutika Edukative: Metodologji Pedagogjike inovative në Qendrat Edukative për Fëmijë. Prishtinë: Koha.
- Oncu, E.C., & Unluer, E.,** (2010). Preschool children’s using of play materials creatively. *ScienceDirect*, 2 (2). 4457-4461. Doi: S1877042810007512.
- Oncu, E.C., & Ozbay, E.** (2005). Play for Children in Early Childhood. *Google Scholar*.
- Piaget, Jean** (1945/1962). Play, dreams, and imitation in childhood. New York: Norton.
- Powell, D.,** (2019). Get Your Game On! 13 Fun Foreign Language Games to Boost Your Vocabulary. *Fluent U - Foreign Language Immersion Online*.
<https://www.fluentu.com/blog/foreign-language-games>.
- Saracho, O.N.,** (2002). Young Children's Creativity and Pretend Play. *Early Child Development and Care*, 172 (2002), pp. 431-438.
- Stetsenko, A. & Ho, Pi-Chun.** (2015). The Serious Joy and the Joyful Work of Play: Children Becoming Agentive Actors in Co-Authoring Themselves and Their World Through Play. *International Journal of Early Childhood*. Doi: 47. 10.1007/s13158-015-0141-1.
- Shahini, M.** (2016). Psikologji e Lojës. Ligjeratë e autorizuar. *Universiteti i Mitrovicës “ Isa Boletini”, Fakulteti i Edukimit*. Mitrovicë.

- Shala, R.**, (2017). *Alternativat e Metodologjive të Edukimit Parashkollor dhe Aplikimi i tyre në Kosovë*. Punim doktore nga Rozafa Shala - Universiteti i Tiranës- Fakulteti i Shkencave Sociale.
- Shaughnessy F, M., Kleyn K.** (2012). *Handbook of Early Childhood Education: First, Chapter: The Importance of Early Childhood Education.,pp.1-9. Researchgate.*
- Soni, R., & Tripathi, B.K.**, (2015). *Theme Based Early Childhood Care and Education Programme. A Resource Book*, 1. 5.
- United Nations Children’s Fund - UNICEF**, 2018. *Learning Through Play: Strengthening Learning Through Play in Early Childhood Education Programmes. UNICEF Education Section, Programme Division.*
[unicef.org/sites/default/files/2018-12/UNICEF-Lego-Foundation-Learning-through-Play.pdf](https://www.unicef.org/sites/default/files/2018-12/UNICEF-Lego-Foundation-Learning-through-Play.pdf)
- Vig, S.** (2007). *Young Children's Object Play: A Window on Development. Journal of Developmental Psychological Disorders*, 19 (2007), pp. 201-215.
- Vygotsky, Lev S.** 1978. *Mind in society*. Cambridge: Harvard University Press.
- Winthrop, R., & Mcgivney, E.** (May 2016). *Skills for a Changing World: Advancing Quality Learning for Vibrant Societies*. Center for Universal Education at Brookings, US
- Zirawaga, V.S., Olusanya, A.I., & Maduku, T.**, (2017). *Gaming in Education: Using Games as a Support Tool to Teach History. Journal of Education and Practice*, 8 (15). 55-63. Doi: 2222-288X.
- Zosh, J.M., Hopkins, J.E., Jensen, H., Liu, C., Neale, D., Hirsh-Pasek, K., Solis, S.L., & Whitebread, D.**, (2017). *Learning through play: A review of the Evidence. The LEGO Foundation.* https://www.legofoundation.com/media/1063/learning-through-play_web.pdf.

